



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/20

Datë: 24.03.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të neni 3 të Ligjit Nr. 03/L-220 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-112 për Tatimin e Normës së Akcizës në Kosovë, të nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive dhe nenit 19 të Rregullores Nr. 09/2011 së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 mars 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Financave për lejimin e importimit të veturave për lëshim në qarkullim të lirë dhe për lëshim në qarkullim të lirë nga çdo depo doganore, për përpunim të brendshëm, për përpunim nën kontroll doganor ose për procedurat e importit të përkohshëm të çfarëdo automjeti motorik të regjistruar për herë të parë brenda ose jashtë Kosovës edhe më shumë se 13 vite (pa kufizim të vjetërsisë), me kusht që plotëson kushtet për qarkullim në komunikacion në Kosovë sipas certifikatës së lëshuar nga Qendra apo Agjenci kompetente.
2. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Financave për shtimin e listës të Aneksit A të Ligjit Nr. 03/L-220 për Tatimin e Normës së Akcizës në Kosovë me këto norma të tatimit të akcizës për vetura sipas viteve të amortizimit dhe fuqisë motorike (cmm) si vijon:

2.1. Për veturat deri në 2000 cmm, norma e tatimit të akcizës do të jetë si vijon:

- Deri në 8 vite të amortizuara, (katërqind) 400.00 euro.
- Deri në 9 vite të amortizuara, (gjashtëqind) 600.00 euro.
- Deri në 10 vite të amortizuara, (shtatëqind) 700.00 euro.
- Deri në 11 vite të amortizuara, (tetëqind) 800.00 euro.
- Deri në 12 vite të amortizuara, (nëntëqind) 900.00 euro.
- Deri në 13 vite të amortizuara, (njëmijë) 1000.00 euro.
- Deri në 14 vite të amortizuara, (njëmijë e njëqind) 1.100.00 euro.
- Deri në 15 vite të amortizuara, (njëmijë e dyqind) 1.200.00 euro.
- Deri në 16 vite të amortizuara, (njëmijë e treqind) 1.300.00 euro.
- Deri në 17 e më shumë vite të amortizuara, (njëmijë e pesëqind) 1.500.00 euro.

2.2. Për veturat prej 2001 cmm deri në 3000 cmm, norma e tatimit të akcizës do të jetë si vijon:

- Për veturat e reja të peregjistruara (treqind) 300.00 euro
- Deri në 8 vite të amortizuara, (katërqind) 400.00 euro.
- Deri në 9 vite të amortizuara, (gjashtëqind) 600.00 euro.
- Deri në 10 vite të amortizuara, (tetëqind) 800.00 euro.
- Deri në 11 vite të amortizuara, (njëmijë) 1000.00 euro.
- Deri në 12 vite të amortizuara, (njëmijë e dyqind) 1.200.00 euro.
- Deri në 13 vite të amortizuara, (njëmijë e katërqind) 1.400.00 euro.
- Deri në 14 vite të amortizuara, (njëmijë e gjashtëqind) 1.600.00 euro.
- Deri në 15 vite të amortizuara, (njëmijë e tetëqind) 1.800.00 euro.
- Deri në 16 vite të amortizuara, (dymijë) 2,000.00 euro.
- Deri në 17 vite e më shumë të amortizuara (dymijë e dyqind) 2.200.00.

2.3. Për veturat mbi 3000 cmm norma e akcizës do të jetë si vijon:

- Për veturat e reja të peregjistruara (tetëqind) 800.00 euro
- Deri në 8 vite të amortizuara, (njëmijë) 1.000.00 euro.
- Deri në 9 vite të amortizuara (njëmijë e pesëqind) 1.500.00 euro
- Deri në 10 vite të amortizuara (njëmijë e tetëqind) 1.800.00 euro
- Deri në 11 vite të amortizuara (dymijë e njëqind) 2.100.00 euro.
- Deri në 12 vite të amortizuara (dymijë e katërqind) 2.400.00 euro.
- Deri në 13 vite të amortizuara (dymijë e shtatëqind) 2.700.00 euro.
- Deri në 14 vite të amortizuara, (tremijë) 3.000.00 euro.
- Deri në 15 vite të amortizuara, (tremijë e treqind) 3.300.00 euro.
- Deri në 16 vite të amortizuara, (tremijë e gjashtëqind) 3.600.00 euro.
- Deri në 17 vite e më shumë të amortizuara (tremijë e nëntëqind) 3.900.00.

2.4. Për të gjitha veturat të cilat lirohen nga detyrimet importuese doganore sipas nenit 2 të Aneksit A të Kodit Doganor dhe Akcizës nr. 03/L-109, me rastin e lindjes së obligimit të pagesës së detyrimeve importuese doganore sipas nenit 7 të Aneksit A të Kodit Doganor dhe Akcizës nr. 03/L-109, vjetërsia e veturës për përcaktimin e normës së akcizës kalkulohet nga data e lindjes së obligimit të pagesës sipas nenit 7 të Aneksit A të Kodit Doganor dhe Akcizës nr. 03/L-109.

3. Vendoset norma e tatimit të akcizës në shumë prej 0.25€ cent për litër në vajra të rënda për ngrohje me një përmbajtje sulfurike më tepër se 0.1% ndaj peshës por jo me tepër se 1% ndaj peshës në përputhshmëri me lejimet sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2012 te datës 27.04.2012 në kodin tarifor 2710196410 dhe 2710196490.

4. Vendoset norma e tatimit të akcizës për mallin si vijon:

- 24021000 Cigaret, cigaret e prera dhe cigarelloset të cilët përmbajnë duhane në shumë prej 35€ për 1000 cope/cigare.
- 240220 Cigaret që përmbajnë duhane në shumë prej 35€ për 1000 cope/cigare.
- 2403 Prodhimet e tjera të përpunuara të duhanit dhe zëvendësimet e përpunuara të duhanit, duhani i "homegjenizuar" apo i ribërë përmes përpunimit, ekstraktet dhe esencat e duhanit në shume prej 35€ për kg.

5. Vendoset norma e tatimit të akcizës për mallin si vijon:

- Pije Alkoolike me kodin doganor 2208 800€ për hektolitër.
- Birrë me kodin doganor 2203 800 € për hektolitër.

6. Lirohet nga detyrimet e akcizës malli:

- Alkool etilik për përdorim Medicinal me kodin doganor 2207 2000 10.

7. Të gjithë prodhuesit vendor të cilët përdorin vajin e rënde sipas paragrafit 3 të këtij Vendimi në proces të prodhimit, pas procesit të prodhimit do të aplikojnë në Doganë të Kosovës për kthim të pagese së tatimit të akcizës në shumën e paguara në emër të tatimit të akcizës për sasinë e vajit të përdorur në proces të prodhimit. Dogana e Kosovës do të nxjerrë akt nënligjor për rregullimin e procedurës së kthimit të tatimit të akcizës në vajin e rënde sipas pikës 3 të këtij Vendimi për prodhuesit vendor.

8. Ky Vendim shfuqizon Vendimin Nr. 05/20 dhe Vendimi Nr. 06/20, të datës 22.06.2011.

9. Obligohet Ministria e Financave dhe Dogana e Kosovës për zbatimin e këtij Vendimi.

10. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAJA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë